FEDASIL INFOPOINT
Rue Héger-Bordet 3, Bruxelles
0800 32 746

IBZ Registration / CUBE
Rue Belliard 68, Bruxelles
(Rruga Belliard 68, 1040 Bruksel)

CGRS/CGRA
Rue Ernest Blerot 39, Anderlecht
+32 2 205 53 05
cgra-cgvs.advocate@ibz.fgov.be

Refugee Medical Point / CROIX ROUGE / Red Cross
Boulevard de Waterloo 125, Bruxelles

INFOLINE VLUCHTELINGENWERK VLAANDEREN
+32 222 54 411 (English, Français, Nederlands, Dari, Pashto)
+32 222 54 421 (Russian, Ukranian)
Whatsapp/Telegram: +32 489 133 355
Monday - Friday: 9.00 - 12.30

LEGAL HELPDESK VLUCHTELINGENWERK VLAANDEREN
QUAI AU BOIS DE CONSTRUCTION 10, Bruxelles

VLUCHTELINGENWERK VLAANDEREN

STARTPUNT VLUCHTELINGENWERK VLAANDEREN

ËSHTË HERA E PARË QË APLIKON PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE NË BELGJIKË

REGJISTRIMI

Në ditën që aplikon për mbrotje ndërkombëtare në qendren e regjistrimit (immigration office (IBZ), Belliardstraat 68/1040 Brussel) ti duhet të jesh prezent para orës 8:30 të mengjesit. Së fundmi, jo të gjithë aplikantet ishin të mundur të hynin cdo ditë brenda. Në qoftë se ti nuk mund të futësh brenda, ty do të jepet një ftesë që të vini në një kohë tjetër specifike; në qoftë se ti nuk marrë një ftesë ju mund të vini të nesërmen(prej të hënës deri të premten).

Në momentin që ti futesh te qendra e regjistrimit, ti do jesh pronë e një kontroll sigurie. Mbasanej ata do ju pyesin për informacion të përgjithshëm(Emër, Mbiemër, vendlindje,datëlindjen dhe gjuhën). Sigurohu që të tregosh gjuhën që ju mund të flisni më mirë; në këtë menyrë ata do të kenë një përkthyes të gjuhës tuaj në cdo intervistë të mëtejshme. Ti mund të kërkosh një perkthyes femër në qoftë se ke preferencë.

Ata do O të marrin një fotografi fytyrës tënde, e cila do jetë për Annx 26 (Bljilage 26), e cila do jetë dokumenti jotë i identifikimit në Belgjikë. Kontrollo në qoftë se informacioni yt personal në Annex 26 është korrekt. Oficeri nga IBZ mund të rregullojë në moment cdo informacion që nuk është e saktë,por gjithashtu mund ta rregullosh gjatë intervistës tënde të parë.

Sigurohu që të mbash të sigurtë Annex-in dhe ta mbash gjithmonë me vete; mund ta fotokopjosh ose të keshë foto të saj në telefon.

AKOMODIMI

Si një azilkërkues, ti ke të drejtën ligjore për një akomodim dhe asistencë shëndetsore gjatë gjithë periudhes së procedurave të azilit.Për shkak të mungesës së vendeve të pritjes

BELGJIKA NUK PO I OFRON BURRAVE BEQAR STREHIM.

Por ti akoma e ke të drejtën për një avokant falas, dhe për kujdes mjekësor dhe psikologjikadvocaat en gratis.

INTERVISTA

Intervista e IBZ

Ti mund të gjesh një datë në Annex-in 26; ajo do të jetë data e intervistës së parë. Intervista e parë mund të bëhet ose mbas disa ditëve osë për disa muaj, varet nga cështja jote. Ti e ke të drejtën për një avokat falas i cili mund të ndihmojë për të përgatitur për intervistën, edhe pse avokati nuk mund të jetë prezent gjatë intervistës të parë. Një përkthyes do të jetë prezent. Në qoftë se ju hasni vështirësi me përkthimin gjatë intervistës (psh. Ju nuk mund ta kuptoni se cfarë po thotë, ose ju ndiheni që ai/ajo nuk po perkthen deklaratën tënde në menyrë korrekte), menjëherë tregoi oficerit.

Gjatë intervistës së parë juve do të pyetni për identitetin tuaj, si keni ardhur në Belgjikë dhe pse jeni larguar nga shteti juaj. Ju duhet të jepni krejt dokumentat dhe provat që mund të mbështesin ceshtjen tuaj, dhe në mënyrë që të tregoni një histori të vertetë dhe të qendrueshme rreth arsyeve pse ju jeni larguar nga shteti juaj dhe pse ju nuk mund të ktheheni më. Ju duhet të jeni të jeni të sinqertë për rrugën që keni bërë për të ardhur në Belgjikë.

Një Oficer do të shkruajë një raport të intervistës tuaj, dhe ju mund të shikoni atë me një perkthyes dhe mund ta ndryshoni në qoftë se ka ndonjë gabim.

Është shumë e rëndësishme qe të shkoni në intervistën tuaj të parë. Në qoftë se ju nuk vini, ti duhet të lajmërosh IBZ sa më shpejtë , dhe të kërkosh një date tjetër për intervistë ose me telefon: 0032/2488.80.00 ose me email:

NL: **asiel.interviews@ibz.fgov.be**
FR: **asile.interviews@ibz.fgov.be**

Procedura e Dublin

Ne qoftë se ti ke dhënë shenjat e gishtave ose ke aplikuar për azil në një shtet tjetër në Bashkimin Europian , ose ke vizë , ose ke një leje qëndrimi në një shtet tjetër të Bashkimit Europian, atëhere është e mundur që Belgjika mos të konsiderojë veten përgjegjës për shqyrtimin e applikacionit për azil. **Atëhere ceshtja jote do të bjerë nën Rregulloren e Dublinit. Data e saj do të shkruhet në Annex 26**. Ju do të pyeteni në intervistën tuaj të parë pse ju deshironi Belgjikën, dhe jo një shtet tjetër të shqyrtojë applikacionin tuaj të azilit.

Në qoftë se ju ndodheni në këtë situatë, është e rëndsishme që:

- Ju të shpjegoni pse doni Belgjikën të shqyrtojë ceshtjen tuaj(psh. Informo IBZ për ndonjë familjar që jeton në Belgjikë ose në një prej shteteve anëtare, në qoftë se ju dëshironi të ribashkoheni me ta; atëhere informoni IBZ dhe sillni prova për cdo problem ose keqtrajtim që ju keni provuar në shtete të tjera të Bashkimit Europian; në rast se ju keni pasur probleme shëndetsore, sillni cdo dokument mjekësor dhe prova të tjera për gjendien tënde mjekësore)
- Ti mund të kesh mbështetjen e një avokati*, i cili mund të informojë dhe të japi mbështetje ligjore në qoftë se duhet.

ADRESA

Në rast se ju nuk keni asnjë akomodim ose address, cdo lajm në lidhje me ceshtjen (psh. Ftesa për intervistë, vendimi) do të dërgohet te CGRS.

Ju duhet të kontrolloni një herë në jave në qoftë se mund të ketë lajme të reja me telefon në numrin (02/205.53.05) ose me emai (cgra-cgvs.advocate@ibz.fgov.be).l

Ti edhe mund të shkosh te CGRS (Ernest Blerostrat 39, Bruksel) për te marrë postën mes orës 10:00 - 11:30 dhe 14:30 - 15:30.

intervistë e CGRA/CGRS

Nëse Belgjika është përgjegjëse për ceshtjen tuaj, ju do të merrni ftese me postë për një intervistë të dytë me Komisionerin e Pergjitshëm për Refugjat (CGRA/CGRS). është e rëndësishme që ju të përgatiteni me një avokat dhe një asistent social; këtë herë avokati mund të marri pjesë në intervistë. Informacioni duhet të jetë i ndershëm dhe të përputhet me intervistën e parë.

Është shumë e rëndësishme që ju të shkoni të inërvista e CGRS. Në qoftë se ju nuk mund të merrni pjesë në intervistë për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, ti duhet të informosh CGRS me letër (Ernest Blerostraat 39 1070 BRUKSEL) jo më vonë se 15 ditë mbas datës së caktuar për intervistë.

Vendimi
Në qoftë se ju merrni një vendim pozitiv juve ju jepet leje qëndrimi në Belgjikë. Në qoftë se ti merr një vendim negativ, atëherë ti mund ta apelosh vendimin brenda 30 ditëve me ndihmën e një avokati.

NUK ËSHTË HERA E PARË QË APLIKON PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE NË BELGJIKË

Nëse aplikimi juaj është mohuar, ju e keni mundësinë të bëni një të re.

Ju do të përsërisni të njejtën procedure të regjistrimit dhe do ju jepet një Annex 26 “quinqueis”. Ju e keni të drejtën për një avokat falas dhe shërbim për urgjencë mjekësore dhe psikologjike. Ti mund të humbësh të drejtën e akomodimit. Megjithatë në qoftë se juve ju duhet një akomodim, mund të konsultoheni me avokatin tuaj sa më shpejtë të jetë e mundur të shikosh a ke të drejtën të apelosh.

Intërvistat

Në intervistën me IBZ ju duhet **të siguroni që të sillni elemente/detaje të reja që ju nuk keni treguar më para** (dokumente, prova, ndryshim në situatën juaj). Nëse CGRS/CGRA pranon këto elemente të reja ata do të ri-shqyrtojnë ceshtjen tuaj.

CGRS do ju informojë juve rreth saj me anë të postës; gjithmonë raporto adresën te IBZ dhe CGRS me anë të një letre të regjistruar ose në person.

Ju do të merrni një vendim me postë; në qoftë se aplikimi juaj është refuzuar ti e ke te drejtën të apelosh vendimin brenda 10 ditëve.